

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Wolfgang Bertelsmeier

Ka lindur në Wiesbaden, Gjermani në 9 Mars 1947.

Wolfgang Bertelsmeier është diplomuar në degët: Administrim Biznesi, Ekonomiks dhe Bankë në Universitetin e Frankfurtit. Pas diplomimit ai punoi për Deutsche Bank në Frankfurt, Gjermani. Më pas iu bashkua Deutsche Entwicklungs Gesellschaft (DEG) si officer projekti në Departamentin në Amerikën Latine.

Para se të punonte për Bankën Botërore në Maj 1976, ai ka mbajtur pozicione të ndryshme duke përfshirë edhe atë të Analistit Financiar në Departamentin që mbulonte Projektet Industriale dhe Energjisë. Në 1987 ai u emërua Analist Financiar i Lartë në Divizionin e Operacioneve për Industrinë dhe Energjinë për Sektorin e Azisë.

Wolfgang Bertelsmeier iu bashkua IFC si Oficer i Lartë Investimesh në muajin tetor 1990. Ai u emërua Përfaqësues Rajonal për IFC dhe mbulonte Afrikën Perëndimore dhe Qëndrore me bazë në Abidjan, Côte d'Ivoire. Në muajin Gusht 1994 ai u rikthye në Zyrat Qëndrore të IFC në Washington ku edhe u emërua Oficer Kryesor Investimesh për Departamentin e Agrobiznesit.

Gjatë kësaj periudhe ai u përfshi në aktivitetet e organizuara nga IFC në Azinë JugLindore duke përfshirë projekte në Vietnam.

Në 1997 Wolfgang Bertelsmeier u emërua Përfaqësuesi i Parë Rezident për IFC në Vietnam. Gjatë periudhës Gusht 2001 – Gusht 2004 ai ishte Menaxher Rajonal I IFC në Brazil dhe më pas u emërua Përfaqësues Special I IFC në Europë deri në vitin 2009.

